Neni 11

Pas nenit 30 shtohet neni 30/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 30/1

Regjistrimi i organizatave jofitimprurëse

1. Detyrimit për t'u regjistruar në organet tatimore dhe për t'u pajisur me certifikatë tatimore u nënshtrohen edhe organizatat jofitimprurëse, fondacionet, njësitë e zbatimit të projekteve etj., që ushtrojnë veprimtari të karakterit fetar, humanitar, bamirës, shkencor ose edukativ, pavarësisht nga fakti se veprimtaria e tyre mund të mos jetë ekonomike e fitimprurëse. Për t'u pajisur me certifikatë tatimore, personat fizikë ose juridikë të mësipërm duhet të paraqesin në organet tatimore, përveç vendimit të gjykatës për regjistrimin e tyre, statutin dhe të dhëna të tjera kontakti. Organet tatimore mbajnë një regjistër të veçantë për evidentimin e këtyre personave, duke i vlerësuar ata, për efekte fiskale, si tatimpagues pasivë.

2. Personat fizikë ose juridikë që detyrohen të regjistrohen në organet tatimore, sipas pikës 1 të këtij neni, të cilët, krahas veprimtarisë me karakter fetar, humanitar, bamirës, shkencor ose edukativ, kryejnë edhe veprimtari të tjera, me karakter ekonomik, janë të detyruar të regjistrojnë veçmas këto veprimtari në organet tatimore, si çdo tatimpagues tjetër, që ushtron veprimtari ekonomike, në përputhje me nenin 30 të këtij ligji."

Neni 12

Në pikën 3 të nenit 33 fjalja e dytë ndryshohet si më poshtë:

"Në rastin e rivlerësimit në rritje të detyrimit tatimor, që nuk buron nga një aktkontroll, tatimpaguesit i lihet një afat sa dyfishi i afatit normal për pagimin e shtesës së detyrimit, si dhe për apelimin e tij në instancat e parashikuara nga ky ligj."

Neni 13

Në nenin 36 bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja "c" ndryshohet si më poshtë:

"c) kur tatimpaguesit deformojnë çmimet e shitjes. Me deformim të çmimeve të shitjes kuptohet çdo rast kur çmimet e shitjes së mallrave e shërbimeve të dokumentuara për efekt të detyrimeve fiskale janë të ndryshëm nga çmimet reale faktike të shitjes nga tatimpaguesi, sipas fakteve të ofruara nga organi tatimor ose janë dukshëm më të ulëta për një kohë të konsiderueshme nga çmimet krahasuese në treg të të njëjtit mall.

Rikarakterizimi i transaksioneve për të reflektuar gjendjen reale të të ardhurave nga shitja e një tatimpaguesi, duke marrë për bazë çmimet reale të tregut, bëhet vetëm me urdhër me shkrim të kryetarit të degës së tatimeve, sipas propozimit me shkrim, të argumentuar me fakte e prova, të inspektorit të kontrollit, për mundësinë e deformimit të çmimeve të shitjes nga tatimpaguesi;"

2. Pas shkronjës "c" shtohet shkronja "ç" me këtë përmbajtje:

"ç) kur tatimpaguesi kryen me lekë në dorë transaksione shitblerjeje që kalojnë shumën 500 mijë lekë për vitin 2004 dhe 300 mijë lekë për vitet në vijim.

Rikarakterizimi i transaksioneve për të reflektuar gjendjen reale ekonomike të një tatimpaguesi mund të bëhet vetëm me urdhër të kryetarit të degës së tatimeve, në bazë të propozimit me shkrim të inspektorëve të grupit të kontrollit. Përcaktimi i detyrimeve tatimore në rastet e mësipërme bëhet sipas udhëzimit në zbatim të këtij ligji, i cili përfshin përdorimin e koeficientëve teknikë, vlerësimin dhe zhvlerësimin e pasurisë, standardet industriale, numrin e punonjësve, llojin e klientëve, çmimet krahasuese dhe qarkullimin e mallrave të tatimpaguesve të ngjashëm. Përcaktimi i këtyre treguesve bëhet në mbështetje të legjislacionit në fuqi, si dhe në bazë të të dhënave të shoqatave të specializuara të biznesit.

Në çdo rast rikarakterizimi i transaksioneve bëhet në mbështetje të ligjeve në fuqi, si dhe në informacionet e ofruara nga Instituti i Statistikave ose shoqatat e specializuara të biznesit dhe i njoftohet në kohë paraprakisht tatimpaguesit."

Neni 14

Në nenin 36/3, pas fjalëve "të të dhënave të tij identifikuese" shtohen fjalët "vërtetuar me fakte të argumentuara nga organi tatimor".

Neni 15

Pas pikës 1 të nenit 45, shtohet pika 1.1 me këtë përmbajtje:

"1.1. Pika 1 e këtij neni nuk zbatohet kur:

a) tatimpaguesi paguan detyrimin tatimor pa përfshirë gjokat dhe interesat dhe njëkohësisht e apelon atë në organet përkatëse.

b) tatimpaguesi vendos garancinë e kërkuar në nenin 43 dhe njëkohësisht apelon detyrimin në organet përkatëse."

Neni 16

Neni 46 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 46

Procedurat e jashtëzakonshme të mbledhjes me forcë të detyrimeve

Për tatimpaguesit, të cilët nuk paguajnë detyrimet e tyre tatimore edhe pas marrjes së masave të zakonshme të nxjerrjes së detyrimeve tatimore, të përcaktuara në nenin 45 të këtij ligji, organet tatimore fillojnë marrjen e masave të jashtëzakonshme, si më poshtë:

a) mbylljen e veprimtarisë ekonomike të tatimpaguesit derisa ky i fundit të ketë shlyer detyrimin e papaguar, por pa kaluar më shumë se 30 ditë kalendarike nga çasti i mbylljes. Për këtë, kryetari i degës së tatimeve nxjerr një vendim të veçantë ekzekutiv, i cili ekzekutohet nga Policia Tatimore;

b) sekuestrimi i pasurisë, në rastet kur tatimpaguesi vazhdon të mos paguajë detyrimin tatimor edhe pse kanë kaluar më shumë se 30 ditë nga çasti i mbylljes së veprimtarisë. Në këtë rast, kryetari i

degës së tatimeve nxjerr një vendim të veçantë ekzekutiv, i cili ekzekutohet nga Policia Tatimore. Vendimi i veçantë ekzekutiv nuk kufizohet vetëm në shumën e tatimeve, por nuk duhet as të tejkalojë masën për sigurimin e pagesës së detyrimeve tatimore. Sekuestrimi i pasurisë ndjek këtë radhë:

- i) pasuritë e luajtshme;
- ii) pasuritë e paluajtshme.

Pasuritë e sekuestruara si më sipër u nënshtrohen dispozitave të ligjit nr. 7697, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative", i ndryshuar;

c) nëse dispozitat e mësipërme nuk mjaftojnë për mbledhjen e detyrimeve tatimore, kryetari i degës së tatimeve merr masat e mëposhtme:

- i) bën denoncim në organet e prokurorisë, në mbështetje të nenit 181 të Kodit Penal;
- ii) kërkon nga organet përkatëse të bllokojnë transferimin e pasurive të tatimpaguesit;

ç) në të gjitha rastet organi tatimor mund të kërkojë fillimin e procedurave të falimentimit si kreditor i interesuar, në mbështetje të ligjit nr.8901, datë 23.5.2002 "Për falimentimin".

Neni 17

Fjala e parë e nenit 47 ndryshohet si më poshtë:

"Në rastet e shkeljeve të legjislacionit tatimor, dënimet përcaktohen në varësi të shkeljes, për rastet konkrete, dhe në bazë të të dhënave të mëparshme për tatimpaguesin."

Neni 18

Neni 49 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 49

Shkeljet dhe dënimet për mosregjistrim

1. Janë shkelje dhe dënohen me gjobë rastet e mëposhtme:

a) kryerja e veprimtarisë pa u pajisur më parë me certifikatën tatimore, e cila dënohet si më poshtë:

- i) mbyllja e veprimtarisë për 15 ditë kalendarike;
- ii) gjobë 75 mijë lekë, për tatimpaguesit e regjistruar në TVSH, të cilëve u ka kaluar afati i regjistrimit;
- iii) gjobë 35 mijë lekë, për tatimpaguesit e taksës vendore mbi biznesin e vogël, të cilëve u ka kaluar afati i përcaktuar në shkronjën "a";
- b) mosnjoftimi i organeve tatimore për ndryshime në të dhënat e tatimpaguesit, si mosnjoftimi për ndryshimin e adresës së veprimtarisë dhe mosnjoftimi i adresave të reja të ushtrimit të veprimtarisë, dënohen me gjobë 35 mijë lekë.

2. Kur edhe pas vendosjes së dënimeve të mësipërme, tatimpaguesi vazhdon të mos regjistrohet, kryetari i degës së tatimeve të rrethit përkatës ka të drejtë të nxjerrë një vendim të veçantë ekzekutiv, me anë të të cilit urdhëron:

- a) vendosjen e sekuestros mbi mallrat, materialet, të ardhurat e realizuara dhe mbi aktivet e tjera, të përdorura për veprimtari ekonomike;
- b) në rastet kur edhe pas marrjes së të gjitha masave të mësipërme tatimpaguesi nuk regjistrohet, ose në rastet e kundërshtimit me dhunë prej tij, drejtpërdrejt ose tërthorazi, vetë ose nëpërmjet personave të tjerë, bëhet kallzim penal, në përputhje me dispozitat e Kodit Penal."

Neni 19

Neni 52 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 52

Shkeljet dhe dënimet për mosdokumentim

Ruajtja, përdorimi dhe transportimi i mallrave pa dokumentacionin e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave, në zbatim të këtij ligji, kur nuk është përcaktuar ndryshe në këtë ligj dhe në ligjet e veçanta tatimore, dënohen me gjobë 40 mijë lekë. Në rastin e transportit të mallrave, përveç gjobës së mësipërme, transportuesit i bllokohet edhe leja e qarkullimit të mjetit, derisa ai të paguajë gjobën.”.

Neni 20

Neni 52/1 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 52/1

Shkeljet dhe dënimet për kryerjen e arkëtimeve dhe të pagesave me lekë në dorë (cash)

Kryerja me lekë në dorë e transaksioneve të shitblerjes, që kalon shumën 500 mijë lekë për vitin 2004 dhe 300 mijë lekë për vitet në vijim, duke përjashtuar personat fizikë jotregtarë, përbën shkelje si për shitësin edhe për blerësin dhe secili prej tyre dënohet me një gjobë të barabartë me 5 për qind të vlerës së transaksionit të kryer.”.

Neni 21

Në fund të paragrafit të parë të nenit 57 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Mosdërgimi i njoftimit për rezultatet e rishqyrtimit nga organet tatimore brenda afatit 30-ditor, vlerësohet si përgjigje në favor të personit të tatueshëm.”.

Neni 22

Në fund të pikës 3 të nenit 63 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Në bazë të rezultateve të kontrollit, organet tatimore përgatisin njoftimin e vlerësimit tatimor. Afati brenda të cilit njoftimi i vlerësimit tatimor përgatitet dhe i njoftohet tatimpaguesit është 15 ditë nga përfundimi i kontrollit. Kohëzgjatja e një kontrolli nuk mund të jetë më shumë se 30 ditë kalendarike. Në raste të veçanta, Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, me kërkesën e degës së tatimeve, mund ta zgjasë këtë afat.”.

Neni 23

Në fund të nenit 68 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Organet tatimore mund të botojnë të dhëna të ndryshme për tatimpaguesit, në formën e një buletini periodik. Lloji i të dhënave që mund të botohen përcaktohet në marrëveshje me Dhomën e Tregtisë dhe të Industrisë.”.

Neni 24

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4077, datë 28.12.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

L I G J

Nr. 9161, datë 18.12.2003

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8438, DATË 28.12.1998 “PËR
TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të

Ministrave,

K U V E N D I I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në fund të nenit 4 shtohet shkronja “i” me këtë përmbajtje:

“i) të ardhura të tjera që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen.”.

Neni 2

Në fund të nenit 8 shtohen shkronjat “f” dhe “g” me këtë përmbajtje:

“f) të ardhurat e realizuara nga diferenca ndërmjet çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së kuotave ose aksioneve, që një ortak ose aksioner zotëron dhe ia shet një personi tjetër;

g) të ardhura të tjera, që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen, të realizuara nga individë rezidentë ose nga persona jorezidentë, por me burim në Republikën e Shqipërisë.”.

Neni 3

Pas nenit 8 shtohet neni 8/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 8/1

Të ardhura të përjashtuara

Përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat vetjake:

1. Të ardhurat e përfituara si rezultat i sigurimit në skemën e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe ndihmat ekonomike për individët pa të ardhura ose me të ardhura të ulëta, sipas përcaktimeve në legjislacionin përkatës në fuqi.

2. Bursat e nxënësve dhe të studentëve.

3. Shpërblimet e marra në raste sëmundjesh, fatkeqësish, në përputhje me dispozitat e legjislacionit përkatës në fuqi.

4. Të ardhurat e përfituara, përfshirë të ardhurat në formë monetare ose në natyrë, nga pronarët si shpërblim për shpronësimet që i bëhen nga shteti për interesa publikë.

5. Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

6. Të ardhurat që përjashtohen në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.”.

Neni 4

Në nenin 9 bëhen këto ndryshime:

a) Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Dividentët, të ardhurat që rrjedhin si fitim i ortakut, qoftë ky ortak i vetëm, interesat nga huatë, depozitat ose kontratat e ngjashme, të ardhurat nga e drejta e autorit ose pronësia intelektuale, si dhe të gjitha shpërblimet ose të ardhurat e tjera që nuk parashikohen ndryshe në dispozita të tjera të këtij ligji, tatohen me 10 për qind.”.

b) Pika 3 shfuqizohet.

Neni 5

Në fund të nenit 10 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Të gjithë punëdhënësit dhe personat e vetëpunësuar janë të detyruar të deklarojnë tatimin mbi të ardhurat vetjake, të mbajtur në burim për punëmarrësit. Forma, përmbajtja, afatet dhe procedurat e dorëzimit të deklarave përcaktohen në udhëzimin e Ministrit të Financave të nxjerrë në zbatim të këtij ligji.”.

Neni 6

Në nenin 14 shtohen shkronjat “e”, “ë” dhe “f” me këtë përmbajtje:

“e) mosdorëzimi në kohë i deklarates për tatimin mbi të ardhurat vetjake të mbajtura në burim sipas nenit 10 dhe mospagimi në kohë i tatimit të kërkuar;

ë) deklarimi më i ulët i të ardhurave vetjake për t’u paguar;

f) mbajtja në burim e tatimit mbi të ardhurat vetjake të punëmarrësve, por mospagimi i tyre në organin tatimor.”.

Neni 7

Në nenin 15 shtohen shkronjat “d”, “dh” dhe “e” me këtë përmbajtje:

“d) për rastet e shkeljeve të dispozitave, të parashikuara në shkronjën “e” të nenit 14, punëdhënësi gjohet me 10 për qind të shumës së tatimit të mbajtur në burim, të deklaruar me vonesë, dhe jo më pak se 10 mijë lekë për çdo muaj ose pjesë të muajit që vijon pas datës që duhet të ishte bërë deklarimi;

dh) për rastet e shkeljeve të dispozitave të parashikuara në shkronjën “ë” të nenit 14, punëdhënësi gjohet me 100 për qind të shumës së detyrimeve që nuk janë paguar;

e) në rastet e shkeljes së dispozitave të parashikuara në shkronjën “f” të nenit 14, punëdhënësi gjohet me 100 për qind të shumës së papaguar të kontributeve. Kur këto kontribute nuk i janë paguar organit tatimor edhe pas një periudhe prej 3 muajsh nga data e përcaktuar në ligjin përkatës, atëherë mbi punëdhënësin bëhet kallëzim penal.”.

Neni 8

Në fund të nenit 20 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Dokumenti i përdorur si bazë për justifikimin e shpenzimit, për efekt tatimor, është fatura tatimore me TVSH, fatura e thjeshtë tatimore dhe çdo dokument tjetër i përpiluar dhe i lëshuar, në përputhje me udhëzimet e Ministrit të Financave, në zbatim të legjislacionit tatimor.”.

Neni 9

Në nenin 21 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronja “h” ndryshohet si më poshtë:

“h) shpenzimet e përfaqësimit dhe shpenzimet për pritje-përcjellje që tejkalojnë shumën 0,3 për qind të qarkullimit vjetor;”.

2. Shkronja “k” ndryshohet si më poshtë:

“k) shpenzimet për dhurata;”.

3. Pas shkronjës “l” shtohet shkronja “ll” me këtë përmbajtje:

“ll) shpenzimet për shërbime teknike, konsulencë dhe të menaxhimit të faturuara nga persona të tretë, por të palikuiduara brenda periudhës tatimore nga tatimpaguesi.”.

Neni 10

Neni 29 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 29

Deklarimi tatimor dhe llogaritja përfundimtare e detyrimit

Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Për efekte fiskale, të dhënat e dokumenteve të mësipërme quhen të pranuar, kur miratohen nga administrata tatimore ose kur kalojnë dy muaj pas dorëzimit të tyre zyrtar dhe administrata tatimore nuk përgjigjet zyrtarisht.

2. Tatimi i llogaritur në bazë të deklaratës vjetore të të ardhurave të tatueshme, pakësuar me shumat e përcaktuara sipas nenit 37 të këtij ligji dhe me parapagimet e bëra gjatë periudhës tatimore, paguhet nga tatimpaguesi në llogarinë e organeve tatimore, në çastin e paraqitjes së deklaratës vjetore të të ardhurave të tatueshme.

3. Çdo parapagim i rezultuar më shumë se tatimi i llogaritur në bazë të pikës 2 të këtij neni, njihet nga organet tatimore për shlyerjen e detyrimeve tatimore të prapambetura ose për pagesën e detyrimeve tatimore të ardhshme ose, me kërkesën e tatimpaguesit, i rikthehet atij nga organet tatimore brenda 60 ditëve nga marrja e deklaratës tatimore."

Neni 11

Shkronja "a" e pikës 2 të nenit 32/1 ndryshohet si më poshtë:

"a) ambulantët në fushën e tregtisë;"

Pas shkronjës "b" të pikës 2 të nenit 32/1 shtohet shkronja "c" me këtë përmbajtje:

"c) ata që realizojnë një qarkullim vjetor prej më pak se 3 milionë lekë në fushën e shërbimeve."

Neni 12

Në fund të nenit 32/5 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

"5. Libri i shitjeve (qarkullimit) dhe fatura e thjeshtë tatimore prodhohen dhe shpërndahen nga organet tatimore, në përputhje me udhëzimin e Ministrit të Financave."

Neni 13

Neni 33 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 33

Mbajtja e tatimit në burim

1. Të gjithë personat juridikë, ortakëritë, personat fizikë, tregtarë, që janë rezidentë shqiptarë, për qëllime tatimore, organet e qeverisjes qendrore e vendore, organizatat jofitimprurëse, mbajnë në burim tatimin në masën 10 për qind për pagesat e mëposhtme:

a) dividendët;

b) ndarjet e fitimit;

c) interesat, përveç interesave të bonove të thesarit dhe të letrave të tjera me vlerë të emetuara nga Këshilli i Ministrave para datës 1 janar 1999;

ç) pagesat për të drejtat e autorit dhe të pronësisë intelektuale;

d) pagesat për shërbimet teknike;

dh) pagesat për menaxhim e për pjesëmarrje në këshillat drejtues;

e) pagesat për ndërtim, instalim, montim ose punë mbikëqyrëse;

ë) pagesat për qiratë;

f) pagesat për argëtues, artistë ose sportistë, në një shfaqje ose prezantim në Republikën e Shqipërisë dhe pagesa të tilla, bërë personave juridikë ose ortakërive, të cilët punësojnë argëtues, artistë ose sportistë ose ndërmjetësojnë shfaqje a prezantime të tilla;

g) çdo pagesë tjetër e bërë për shërbime, jo për mallra, që nuk përfshihet në pikat e mësipërme.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet vetëm kur pagesat u bëhen personave, të cilët nuk janë subjekt i

tatimit mbi fitimin ose i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, si edhe kur pagesat u bëhen personave jorezidentë shqiptarë.

3. Pika 1 e këtij neni zbatohet edhe ndaj jorezidentëve, për pagesa të tilla, të lindura nga një person me seli të përhershme që ai mban në Republikën e Shqipërisë.

4. Pika 1 e këtij neni nuk do të zbatohet ndaj pagesave që i bëhen personave jorezidentë shqiptarë për shërbime të transportit ndërkombëtar të pasagjerëve dhe të mallrave.”.

Neni 14

Neni 34 shfuqizohet.

Neni 15

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.4078, datë 28.12.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

Pasqyra nr.3

TARIFAT E TATIMIT TË THJESHTUAR MBI TË ARDHURAT

Nr.	Tipi (lloji) i biznesit	Tarifa e tatimit të thjeshtuar
1.	Shitje me pakicë	4 për qind
2.	Prodhim	4 për qind
3.	Shërbime	5 për qind
4.	Profesione të lira	5 për qind

L I G J

Nr.9162, datë 18.12.2003

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7928, DATË 27.4.1995 "PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I **I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Pas pikës 1 të nenit 3 shtohet pika 1/l me këtë përmbajtje:

"1/l. Personi i tatueshëm, shitës mallrash me shumicë, detyrohet të kërkojë të regjistrohet edhe

në rastet kur qarkullimi i tij vjetor nuk e kalon kufirin minimal të regjistrimit, i parashikuar në pikën 4 të këtij neni."

Neni 2

Pas pikës 2 të nenit 20 "Toka dhe ndërtesat" shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

"3. Dhënia me qira e ndërtesave pronë publike nga organet e pushtetit qendror ose vendor është furnizim i përjashtuar."

Neni 3

Pas nenit 24 shtohet neni 24/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 24/1

Furnizimi i shërbimeve arsimore nga institucionet arsimore publike dhe private, në përputhje me ligjin nr.7952, datë 21.6.1995 "Për sistemin arsimor parauniversitar" dhe ligjin nr.8461, datë 25.2.1999 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", është furnizim i përjashtuar."

Neni 4

Shkronja "a" e pikës 4 të nenit 26 ndryshohet si më poshtë:

"a) shpenzimet e transportit e të sigurimit dhe shpenzimet e tjera, të përfshira në importimin e mallrave dhe livrimin e tyre, deri në çastin e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë;"

Neni 5

Në nenin 26/1 pas shkronjës "d" shtohet shkronja "dh" me këtë përmbajtje:

"dh) importimi i kafshëve të gjalla të racës, të dhuruara nga donatorë të ndryshëm."

Neni 6

Pas pikës 3 të nenit 28 "Detyrimet mbi furnizimet" shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

"4. Për mallrat, të cilat pësojnë humbje gjatë tranzitimit, magazinimit dhe prodhimit, siç përcaktohet në akte të veçanta ligjore dhe nënligjore, nuk llogaritet dhe nuk paguhet TVSH-ja."

Neni 7

Në nenin 36 bëhen këto shtesa dhe ndryshime.

1. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

"1/1. Në fund të faturës shënohet blerësi me emër, mbiemër, nënshkrim, transportuesi me emër, mbiemër, nënshkrim dhe shitësi me emër, mbiemër, nënshkrim dhe vulë. "

2. Pas shkronjës "b" të pikës 2 shtohet shkronja "b/1" me këtë përmbajtje:

"b/1) emrin, adresën dhe NIPT-in e transportuesit, targën e mjetit dhe orën e furnizimit."

Pas pikës 7 shtohet pika 8 me këtë përmbajtje:

"8. Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, sipas kritereve të përcaktuara me udhëzim nga Ministri i Financave, ka të drejtë të autorizojë personat e tatueshëm, që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e përpunimit të qumështit, përpunimit të ullirit, përpunimit të rrushit dhe të bluarjes së grurit, të lëshojnë fatura tatimore për veten, për sasinë e qumështit, të ullirit, të rrushit dhe të grurit, me të cilën janë furnizuar nga persona të tjerë të paregjistruar për tatimin mbi vlerën e shtuar."

Neni 8

Në fund të pikës 7 të nenit 42 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

"Mosdërgimi i njoftimit për rezultatet e rishqyrtimit nga organet tatimore, brenda afatit 30-ditor,

vlërësohet si përgjigje në favor të personit të tatueshëm. ".

Neni 9

Në fund të nenit 52 shtohen fjalët "sipas afateve dhe rregullave të përcaktuara në ligjin nr.9160, datë 18.12.2003 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.4079, datë 28.12.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

L I G J **Nr.9163, datë 18.12.2003**

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8976, DATË 12.12.2002 "PËR AKCIZAT", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.9041, DATË 27.3.2003

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I **I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8976, datë 12.12.2002 "Për akcizat", ndryshuar me ligjin nr.9041, datë 27.3.2003, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 4, pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

"3/1. Çdo person që importon malto dhe nuk është i autorizuar si prodhues birre, është i detyruar të pajiset me autorizim nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Ministri i Financave përcakton me udhëzim rregullat për vendosjen e garancisë para importimit të maltos, për dokumentacionin e nevojshëm dhe për kthimin e garancisë."

Neni 2

Shkronja "b" e pikës 1 të nenit 10 ndryshohet si më poshtë:

"b) për t'u dërguar në një magazinë tjetër tatimore të miratuar;".

Neni 3

Pas pikës 2 të nenit 19 shtohen pikat 3 dhe 4 me këtë përmbajtje:

"3. Përfshihet nga akcizat importimi i nënprodukteve të naftës, për nevojat e veta, nga subjektet e kërkimit të naftës dhe të vënies në shfrytëzim të zonave naftëmbajtëse, të cilat, në mbështetje të ligjeve nr.7746, datë 29.7.1993 "Për hidrokarburet" dhe nr.7811, datë 12.4.1994 "Për sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve" dhe në bazë të marrëveshjeve, që kanë nënshkruar me Qeverinë Shqiptare, kanë rënë dakord për ndarjen e prodhimit dhe për tatimin mbi fitimin në masën 50 për qind. Përcaktimi dhe dokumentimi i sasive që këto subjekte përdorin për nevoja të shpimeve për kërkimin dhe vënien në shfrytëzim të zonave naftëmbajtëse do të përcaktohen në udhëzimin e

përbashkët të Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Industrisë dhe Energjetikës.

4. Përfshihet nga akciza sasia e karburantit, që përdoret për projektin pilot për mekanikën bujqësore dhe serat me ngrohje.

Përcaktimi i sasisë së karburantit dhe skema e përdorimit të tij bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe udhëzim të përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit.”.

Neni 4

Neni 47 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 47

Shkelja e afatit kohor për pagesën e akcizës

Kur personi i autorizuar i akcizës nuk ka paguar shumën e caktuar brenda datës së caktuar, ai është i detyruar të paguajë një gjobë të nivelit B, të shkallës standarde, sipas nenit 51 të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 "Për akcizat", ndryshuar me ligjin nr.9041, datë 27.3.2003, plus interesin e llogaritur në përputhje me ligjin nr.8980, datë 12.12.2002 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.”.

Neni 5

Në pikën 2 të nenit 49, fjala “sekuestrohen” zëvendësohet me fjalën “konfiskohen”.

Neni 6

Shtoja nr.1, që i bashkëlidhet ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 "Për akcizat", ndryshuar me ligjin nr.9041, datë 27.3.2003 zëvendësohet me shtojcën nr.1.1, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.4080, datë 28.12.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

Shtojca 1.1

MALLRAT E TATUESHME ME AKCIZË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Kodi NK	Përshkrimi	Shkalla tatimore
I	KAFE	
09 01 11 00 09 01 12 00	Kafë jo e pjekur e dekafeinizuar ose jo	40 lekë/kg
09 01 21 00 09 01 22 00	Kafë e pjekur e dekafeinizuar ose jo	80 lekë/kg
09 01 90	Lëkura dhe lëvoret e kafesë Zëvendësuesit e kafesë që përmbajnë kafë	40 lekë/kg
21 01 11 21 01 12	Ekstrakte, esenca, koncentre kafeje dhe përgatitje prej tyre (neskafë etj.)	250 lekë/kg
II	LËNGJE FRUTASH, UJË DHE PIJE FRESKUESE	
20 09	Lëngje frutash dhe perimesh të pafermentuara, pa shtesa alkoolike, që përmbajnë ose jo lëndë	3 lekë/litri

	embëlsuese	
22 02	Ujërat minerale ose të gazuara, me ëmbëlsues ose aromatizues shtesë, pijet freskuese joalkoolike, përjashtim lëngjet e frutave	3 lekë/litri
III	BIRRË, VERË, ALKOOL DHE PIJE ALKOOLIKE	
22 03	Birrë e bërë nga malto	30 lekë/litri
22 04	Verë dhe verërat e gazuara; shampanjë; musht rrushi	20 lekë/litri
22 05	Vermut e verëra të tjera të përgatitura nga bimë ose substanca aromatizuese	20 lekë/litri
22 06	Të tjera pije të fermentuara (p.sh. cider, cider dardhe, hydromel); përzierje të pijeve të fermentuara dhe pijeve joalkoolike të papërmendura diku tjetër	20 lekë/litri
22 07 10 00	Alkool etilik jo i denatyrar i një force alkoolike ndaj volumit prej 80% ose më tepër	100 lekë/litri
22 07 20 00	Alkool etilik i denatyrar	0
22 08	Alkool etilik jo i denatyrar i një force alkoolike deri në 80%; pije alkoolike, likerna dhe alkoole të tjera	100 lekë/litri
22 08 20 29	Raki	80 lekë/litri
IV	DUHAN DHE NËNPRODUKTET E TIJ	
24 02 10 00	Puro dhe cigarillos që përmbajnë duhan	2 240 lekë/kg
24 02 20	Cigare që përmbajnë duhan	20 lekë/paketa
24 02 90	Puro, cigarillos dhe cigare me zëvendësues duhani	2 240 lekë/kg
24 03	Duhan tjetër i përpunuar dhe zëvendësuesit e duhanit, duhan i homogjenizuar ose i rindërtuar, ekstrakte dhe esenca prej duhani	1 500 lekë/kg
V	NËNPRODUKTET E NAFTËS	
27 10 11 41 27 19 11 45 27 10 11 49	Vajra të lehtë (benzinë dhe benzol) Benzinë dhe benzol pa plumb, me përmbajtje plumbi jo më tepër se 0,013 gr/litër me më pak se 95 oktan me 95-98 oktan me 98 e më shumë oktan	33 lekë/litri
27 10 11 51 27 10 11 59	Benzinë me plumb, me përmbajtje plumbi më tepër se 0,013 gr/litër me më pak se 98 oktan - me 98 e më shumë oktan	38 lekë/litri
27 10 19 11 deri 27 10 19 29 27 10 19 21	Vajguret Karburant jet, tip vajguri	20 lekë/litri 0
27 10 19 31 deri 27 10 19 49	Vajra të rënda (gazoil)	65 për qind
27 10 19 51 deri 27 10 19 69	Vajra të rënda si lëndë djegëse (lëndë djegëse, solar, mazut)	1 lek/kg
27 10 19 71 deri 27 10 19 99	Vajra lubrifikante dhe vajra të tjera	40 lekë/kg

27 13 11 00 27 13 12 00	Koks nafte i kalçimuar ose jo	1 lek/kg
27 13 20 00	Bitum nafte	5 lekë/kg
27 13 90	Mbetje të vajrave të naftës dhe të mineraleve bituminoze (bitumen)	5 lekë/kg
27 14	Bitum dhe asfalt, natyral, rreshpe bituminoze ose rreshpe nafte dhe rëre bituminoze; asfaltet dhe gurët asfaltikë	5 lekë/kg
27 15	Përzierje bituminoze të bazuara në asfaltin natyral, në bitumen e naftës, në katranin mineral, ose në terpentinën e katranit mineral (masticet bituminoze)	5 lekë/kg
29 01 29 02	Hidrokarbure aciklike dhe ciklike përfshirë (etilen, benzen, toluol, ksilol)	5 lekë/kg
VI	ARTIKUJ KOZMETIKË, PARFUMERI DHE TUALETI	
33 03 00 10 33 03 00 90 33 07 20 00	Parfume Ujëra tualeti Deodorante	50 për qind 50 për qind 50 për qind

L I G J
Nr.9164, datë 18.12.2003

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9136, DATË 11.9.2003 “PËR MBLEDHJEN E KONTRIBUTEVE TË DETYRUESHME TË SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.9136, datë 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Pika 2 e nenit 9 shfuqizohet.

Neni 2

Neni 10 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 10
Detyrimi për të deklaruar

1. Personi i detyruar për të paguar kontribute duhet të dorëzojë në organet tatimore një deklaratë

për çdo periudhë.

2. Deklarata duhet të përmbajë shumën e kontributeve për t'u paguar, shumën dhe tipin e përfitimeve të paguara dhe vlerën e kontributeve të paguara.

3. Personat që janë të detyruar të paguajnë kontribute dorëzojnë në organin tatimor deklaratën përkatëse, ku shënohet për çdo person emri, numri i sigurimeve shoqërore, shuma e kontributeve për t'u paguar dhe shuma e përfitimeve.

4. Formularët e deklarimit, të përmendur në pikat 1 dhe 3 të këtij neni, përcaktohen në udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale, në zbatim të këtij ligji."

Neni 3

Neni 11 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 11

Afatet e deklarimit dhe të pagesës

1. Deklarata e përmendur në pikën 1 të nenit 10 dhe pagesa e kontributeve bëhen në afatet e mëposhtme:

- a) nga punëdhënësi, çdo muaj, jo më vonë se data 25 e muajit pasardhës;
- b) nga personi i vetëpunësuar, jo më vonë se data 25 e muajit të fundit të çdo tremujori të vitit kalendarik, siç përcaktohet në udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Punës e Çështjeve Sociale, në zbatim të këtij ligji.

2. Deklarata e përmendur në pikën 3 të nenit 10 bëhet në afatin e përcaktuar në udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Punës e Çështjeve Sociale, në zbatim të këtij ligji."

Neni 4

Fjala e fundit e pikës 2 të nenit 13 shfuqizohet.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.4081, datë 28.12.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI TETOR 2003

1.	KUSHTETUTA	600
2.	PËRMBLEDHËSE NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000
3.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
4.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
5.	KODI PENAL	400
6.	KODI I PUNËS	500
7.	KODI I FAMILJES	450
8.	KODI CIVIL	1000
9.	KODI RRUGOR	900
10.	KODI ZGJEDHOR	355
11.	PËRMBLEDHËSE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
12.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT DOGANOR	1500
13.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

Doli nga shtypi më 31.12.2003

Tirazhi: 4300 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja Kristalina KH

Çmimi: 150 lekë